

L I G J
Nr. 7875, datë 23.11.1994

PËR MBROJTJEN E FAUNËS SË EGËR DHE GJUETINË

(Ndryshuar me ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002; nr. 9219, datë 8.4.2004)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Fauna e egër e Republikës së Shqipërisë përbën një pasuri kombëtare, që administrohet dhe mbrohet nga shteti nëpërmjet ligjit në interes të gjithë vendit dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, ku aderon Republika e Shqipërisë.

Neni 2

Në faunën e egër bëjnë pjesë kafshët dhe shpendët e egra që formojnë popullata në gjendje të lirë, të ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë, në mënyrë të përhershme ose të përkohshme.

Neni 3

Fauna e egër, që rritet në mënyrë natyrore ose e kultivuar dhe që ndodhet në gjendje të lirë në territorin e Republikës së Shqipërisë, është objekt i veprimtarisë së gjuetisë në përputhje me normat e parashikuara në këtë ligj dhe aktet e tjera nënligjore.

Neni 4

Fauna e egër, në gjendje të lirë ose të kultivuar, është objekt i masave mjekësore veterinarë, sipas ligjeve në fuqi dhe akteve ndërkombëtare të nënshkruara nga shteti ynë.

Neni 5

(Ndryshuar me ligjin nr. 9219, datë 8.4.2004)

Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve dhe Kullotave ngrihet Këshilli Kombëtar për Faunën e Egër dhe Gjuetinë, për të lehtësuar zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore.

Këshilli Kombëtar për Faunën e Egër dhe Gjuetinë ka për detyrë:

a) miratimin e programeve për zhvillimin e faunës së egër dhe të veprimtarisë së gjuetisë;

- b) miratimin e planeve vjetore të mbarështimit të faunës së egër;
- c) miratimin e projekteve për zhvillimin e faunës së egër;
- ç) miratimin e kalendarit të gjuetisë;
- d) kontrollin e kryerjes së detyrave nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor për ruajtjen e faunës së egër dhe realizimin e veprimtarisë së gjuetisë.

Përbërja dhe funksionimi i Këshillit Kombëtar për Faunën e Egër dhe Gjuetinë përcaktohen me urdhër të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit.

KREU II FONDI I GJUE TISË, HAPËSIRAT E TIJ DHE KOMPETENCAT MBI KËTË FOND

Neni 6

Fondi i gjuetisë përbëhet nga:

- a) kafshët dhe shpendët e egra;
- b) sipërfaqja e fondit të gjuetisë.

Neni 7

(Shtuar togfjalësh në paragrafin e parë me ligjin nr. 9219, datë 8.4.2004)

Në sipërfaqen e fondit të gjuetisë, pavarësisht nga pronësia, publike ose private përfshihen territoret e populluara me kafshë e shpendë të egra si vijon:

- a) fondi pyjor, kullosor dhe livadhet;
- b) tokat bujqësore;
- c) sipërfaqet ujore të brendshme (lagunat që lidhen me detin, kënetat, liqenet natyrore e artificiale, përrrenjtë dhe ujëmbledhësit);
- ç) shkëmbinjtë, rrëpirat, humnerat, ranishtet.

Nuk përfshihen në fondin e gjuetisë sipërfaqet e zonave urbane dhe territoret brenda largësisë 150 m nga periferia e tyre, rrugët automobilistike e hekurudhore dhe ujërat detare.

Neni 8

(Shfuqizuar shkronja "c" me ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002; shtuar shkronja "c" me ligjin nr. 9219, datë 8.4.2004)

Sipërfaqja e fondit të gjuetisë, në përputhje me kërkesat biologjike dhe gjendjen e faunës së egër, ndahet në zona gjuetie, sipas këtyre kategorive:

- a) zona të lira gjuetie;
- b) zona të ripopullimit dhe të kapjes së gjahut për popullim;
- c) zona të rezervuara për gjueti;
- ç) rezervate faunistike.

Neni 9

(Ndryshuar togfjalësh në paragrafin e parë dhe ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 9219, datë 8.4.2004)

Zonat e ripopullimit dhe të hapjes, zonat e rezervuara për gjueti, ato faunistike dhe rezervatet natyrore mund të krijohen në sipërfaqe që i përkasin shtetit, me propozim të institucionit që i ka në administrim ose në toka private, në marrëveshje me personat fizikë e juridikë përkatës.

- a) Zona për ripopullim dhe kapje të gjahut ka si qëllim rritjen dhe zhvillimin e faunës

së egër për popullim.

b) Rezervatet e gjuetisë kanë për qëllim administrimin e përhershëm të faunës së egër për gjueti rikreative dhe turizëm.

c) Rezervatet faunistike dhe rezervat natyrore kanë për qëllim një mbrojtje absolute të faunës së egër që jeton atje e të pasurive të tjera natyrore dhe ndalohet ushtrimi i gjuetisë e peshkimit.

Miratimi i këtyre zonave bëhet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Pyjeve dhe Kullotave.

Neni 9/1

(Shtuar me ligjin nr. 9219, datë 8.4.2004)

Të drejtat e pronësisë mbi fondin e gjuetisë ushtrohen pa cenuar funksionet ekologjike dhe të zhvillimit të faunës së egër.

Të drejtat dhe detyrimet e pronarëve privatë e publikë dhe të shoqatave të gjuetarëve për administrimin e fondit të gjuetisë dhe kryerjen e veprimtarisë së gjuetisë sportive e turistike përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit.

Neni 10

(Shfuqizuar me ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002)

KREU III

PLANIFIKIMI DHE VJELJA E GJAHUT

Neni 11

(Ndryshuar emërtim në paragrafin e dytë me ligjin nr. 9219, datë 8.4.2004)

Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe e Kullotave kryen inventarizimin e specieve të faunës së egër dhe përditësimin e saj.

Në bazë të inventarizimit të faunës së egër, gjendjes shëndetësore e strukturave të gjuetisë, Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave harton një plan kombëtar të vjeljes së gjahut në konsultim me Ministrinë e Mjedisit dhe me institucionet e tjera të interesuara.

Neni 12

(Ndryshuar emërtim me ligjin nr. 9219, datë 8.4.2004)

Këshilli Kombëtar për Faunën e Egër dhe Gjuetinë, para hapjes së sezonit të gjuetisë, miraton programin e vjeljes së gjahut dhe përcakton limitet e vrasjes ditore për secilin lloj gjahu nga një gjuetar, si dhe ditët e ushtrimit të gjuetisë, të cilat janë detyruesisht të zbatueshme.

Neni 13

(Shfuqizuar me ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002)

Neni 14

(Ndryshuar me ligjin nr. 9219, datë 8.4.2004)

Për ruajtjen, administrimin dhe rritjen e faunës së egër, shteti nxit investimet private në pjesë të fondit kombëtar të gjuetisë, në pronësi publike e private, për mbarëshkrimin e faunës së egër, për argëtim, çlodhje, gjueti dhe për veprimtari biznesi, pa cenuar vlerat dhe funksionet e tyre.

Dhënia në përdorim e pjesëve të fondit publik të gjuetisë, për qëllimet e caktuara në paragrafin e parë të këtij neni, bëhet vetëm në bazë të rregullave dhe të procedurave, të përcaktuara nga Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit.

Neni 15

Personat juridikë dhe fizikë, vendas e të huaj, me autorizimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve dhe Kullotave, në fondin pyjor në tokë private mund të bëjnë mbarështimin dhe rritjen artificiale të kafshëve e shpendëve të egra për qëllime ripopullimi, tregtimi, ushqimi dhe zbukurimi.

Këto subjekte detyrohen që deri në 10 për qind të prodhimit vjetor ta përdorin për ripopullimin e zonave pyjore pa pagesë.

Neni 16

Tarifat për vjeljen e gjahut dhe ushtrimin e gjuetisë, për hyrjet në rezervatet e gjuetisë, ato faunistike dhe rezervat natyrore, për qiranë dhe çështje të tjera të kësaj natyre, caktohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave dhe Ministria e Financave.

Neni 17

Tregtimi i lëkurëve të kafshëve të egra, si dhe i kafshëve e shpendëve të egra të gjalla, të balsamosura, trofe, të vrara nga personat juridikë e fizikë, shtetërorë dhe privatë, vendas a të huaj, duhet të shoqërohet me lejë të organeve pyjore, të cilat vërtetojnë vrasjen ose kapjen sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 18

Bretkosat, kërmijtë, breshkat, reptilet dhe çdo qenie e gjallë që rriten e zhvillohen në fondin pyjor e të gjuetisë janë pronë e shtetit, me përjashtim të rasteve kur krijohen mjedise në toka private.

Grumbullimi i tyre bëhet pasi të jetë marrë leja nga organet pyjore të rrethit, duke marrë masat për ruajtjen dhe shfrytëzimin mbi baza biologjike e teknike.

Neni 19

Shteti mbështetet me fonde buxhetore mbrojtjen, zhvillimin dhe mbarështimin e faunës së egër, të ekosistemeve natyrore ku jeton fauna dhe përballon situatat emergjente në rastet e fatkeqësive të mëdha natyrore.

KREU IV USHTRIMI I GJUETISË

Neni 20

Gjuetia zhvillohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji, si dhe në bazë të akteve të tjera nënligjore në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, që përfshihet në fondin e gjuetisë.

Neni 21

Ushtrim gjuetie quhet çdo akt që lidhet drejtpërdrejt me vrasjen dhe kapjen e kafshëve

e të shpendëve të egra, ndjekja pas gjahut ose pritja për ta vrarë ose kapur nëpërmjet përdorimit të mjeteve të lejuara për gjueti.

Neni 22

(Shfuqizuar me ligjin nr. 9219, datë 8.4.2004)

Neni 23

(Ndryshuar me ligjin nr. 9219, datë 8.4.2004)

Personat juridikë ose fizikë nuk mund ta ushtrojnë veprimtarinë e mbarështimit të faunës së egër ose dhe të gjuetisë sportive e turistike, përveç atyre që zotërojnë të drejtat e siguruara nga ky ligj dhe që janë të pajisur me lejet përkatëse.

Të drejtat, që sigurohen nga leja e ushtrimit të veprimtarisë, nuk mund të transferohen ose t'u jepen personave të tjerë.

Pronarët e tokës private lejojnë ushtrimin e gjuetisë sportive e turistike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me aktet e tjera nënligjore. Marrëdhëniet dhe rregullat e ushtrimit të veprimtarisë së gjuetisë në pronën private caktohen me rregullore të veçantë të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe e Kullotave është autoriteti që lëshon lejet vjetore të gjuetisë.

Neni 24

Gjuetari është i detyruar t'i deklarojnë Drejtorisë së Shërbimit Pyjor në rreth numrin e kafshëve e të shpendëve të egra të gjuajtura, sipas mënyrës së shprehur në aktet ligjore dhe rregulloret përkatëse.

Çdo gjuetar është i detyruar të njoftojë e dorëzojë në qendrën veterinare më të afërt gjahun e gjuajtur që ka shenja sëmundjeje.

Neni 25

Gjuetia ushtrohet me armë gjahu, me hark dhe falkua dhe në raste të veçanta me miratim të Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve dhe Kullotave, mund të lejohet përdorimi i kurtheve dhe i mjeteve të tjera.

Zotëruesi i lejës së armës për gjueti autorizohet të mbajë me vete vegla me majë e me teh që shërbejnë për gjueti.

Neni 26

(Ndryshuar me ligjin nr. 9219, datë 8.4.2004)

Veprimtaria e gjuetisë ushtrohet nga shtetasi që:

- a) ka mbushur moshën 18 vjeç;
- b) ka kaluar testin e hartuar sipas rregullave të caktuara nga Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit;
- c) është pajisur me lejen për ushtrimin e gjuetisë;
- ç) është anëtar i shoqatave të gjuetarëve;
- d) përmbush detyrimet që rrjedhin nga ligji "Për armët".

Neni 27

Gjahu i vrarë gjatë ushtrimit të gjuetisë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore, i përket atij që e ka vrarë.

Personat fizikë e juridikë të huaj, kur largohen nga territori i Republikës së Shqipërisë, kanë të drejtë të marrin me vete gjahun e vrarë ose të kapur pasi të jenë pajisur me vërtetim nga organet pyjore dhe shërbim veterinar i rrethit përkatës.

Neni 28

(Ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 9219, datë 8.4.2004)

Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave, në bashkëpunim me institucionet e tjera të interesuara, përcakton llojet e faunës së egër që janë objekt gjuetie dhe kalendarin e gjuetisë së tyre. Çdo gjuetar është i detyruar të respektojë dhe të zbatojë kalendarin e gjuetisë.

Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, për arsye të veçanta ekologjike, për specie që paraqesin rrezik zhdukjeje ose që janë të kërcënuara për t'u zhdukur, në gjendje ekologjike të rënduar dhe në raste fatkeqësish natyrore, ndalon veprimtarinë e gjuetisë në të gjithë territorin e vendit ose në disa zona të caktuara.

Neni 29

Drejtoria e Shërbimit Pyjor në rrethe cakton zona gjuetie, të cilat do të përdoren nga gjuetarët për stërvitjen e zagarëve të gjuetisë.

Stërvitësit janë të detyruar të respektojnë kufijnjtë e zonave dhe rregullat e vendosura.

Neni 29/1

(Shtuar me ligjin nr. 9219, datë 8.4.2004)

Pas përfundimit të sezonit të gjuetisë, nga organet e rendit publik, në bashkëpunim me ato pyjore, bëhet, detyrimisht, vulosja e armëve të gjahut, të cilat zhvulosen para fillimit të sezonit pasardhës, kur përdoruesit kanë shlyer taksat dhe tarifën e caktuar dhe kur nuk kanë shkelur dispozitat ligjore, që rregullojnë mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë.

Procedurat e vulosjes së armëve përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Rendit Publik dhe të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit.

KREU V

MBROJTJA E FONDIT TË GJUETISË

Neni 30

Mbrojtja e faunës së egër dhe zbatimi i dispozitave ligjore të këtij ligji e të akteve të tjera nënligjore është detyrë e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, e organeve të ruajtjes së rendit publik, e organeve të pushtetit lokal, e shoqatës së gjuetarëve dhe peshkatarëve sportivë, si dhe e çdo personi tjetër juridik a fizik, shtetëror ose privat, vendas a i huaj, që lidhen me këtë aktivitet.

Neni 31

(Ndryshuar me ligjin nr. 9219, datë 8.4.2004)

Drejtoria e shërbimit pyjor në rreth drejton, organizon, kontrollon dhe përgjigjet për

mbrojtjen e faunës së egër e për miradministrimin e saj në të gjithë fondin e gjuetisë.

Personat juridikë dhe fizikë, që kanë në pronësi pjesë të sipërfaqeve që ndodhen brenda fondit të gjuetisë, mund t'i administrojnë dhe përdorin këto sipërfaqe vetëm sipas kërkesave të planit të mbarështimit të faunës së egër dhe në rastet kur rritja e kafshëve dhe e shpendëve të egra bëhet prej tyre. Ata nuk kanë të drejtë të ushtrojnë veprimtarinë e gjuetisë ose të lejojnë kryerjen e kësaj veprimtarie (në pronat e tyre private) nga personat e tjerë, pa lejen e organeve të shërbimit pyjor.

Neni 32

Të gjitha speciet e faunës së egër që nuk përfshihen në listën e gjahut si objekt gjuetie, përveç minjve mbrohen me ligj.

Këto specie mund të gjuhen në raste të veçanta për qëllime shkencore dhe studimore, kur bëhen të rrezikshme dhe në raste sëmundjesh, gjurmimesh ose marrje masash veterinare, për muze, laboratorë dhe kopshte zoologjike, për seleksionimin e faunës së egër dhe popullimin e zonave të tjera, në çdo kohë e vend, me autorizimin e posaçëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve dhe Kullotave.

Neni 33

Personat juridikë dhe fizikë, shtetërorë ose privatë, vendas a të huaj, kur ushtrojnë peshkimin, duke përfshirë edhe ujërat bregdetare, nuk kanë të drejtë të ushtrojnë gjueti për kafshë e shpendë të egra edhe në territore që i kanë në përdorim ose në pronësi, kur nuk janë pajisur me leje gjuetie.

Neni 34

Në lagunat dhe në zonat kënetore, brenda territoreve të rezervave të gjuetisë dhe ato faunistike, ndalohet kryerja e çfarëdo veprimi që ndikon në cilësinë dhe natyrën e ekosistemit.

Neni 35

Për mbrojtjen e faunës së egër ndalohet:

1- Gjuetia e kafshëve dhe e shpendëve të egra, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në nenin 32 dhe të specieve të emërtuara në listën e gjahut si objekt gjuetie.

2- Gjuetia në zonat e riprodhimit dhe të kapjes, në rezervatet faunistike, në rezervat natyrore, në parqet kombëtare pyjore, në parqet e lulishtet, në qendrat urbane dhe në çdo zonë tjetër, ku ajo është e ndaluar përkohësisht.

3- Qarkullimi i lirë i qenve dhe maceve endacake, i bagëtive dhe zagarëve të gjuetisë në rezervate (zagarët mund të lejohen vetë në raste të përcaktuara me rregullore).

4- Ushtrimi i gjuetisë në det dhe në rajonet e caktuara për zhvillimin e peshkokulturës.

5- Ushtrimi i gjuetisë në formë shëtitjeje në zona të kultivuara me bimë bujqësore.

6- Ushtrimi i gjuetisë, duke gjuajtur nga makina, mjetet e lundrimit (veç barkave që përdoren për gjueti) dhe mjetet e fluturimit.

7- Ushtrimi i gjuetisë në periudhën e ndaluar, jashtë afateve të lejuara ose pa dokumentacionin përkatës.

8- Ushtrimi i gjuetisë me mjete jo të autorizuar për tipim e gjuetisë që ushtrohet, me mjete e mënyra që përbëjnë rrezik për njerëzit, kafshët e shpendët, me anë të zjarrit, me materiale që marrin shpejt zjarr, me lëndë eksplozive dhe helmuese, të hapjes së gropave, me dritë, me ajër e gaz të komprimuar dhe natën.

9- Gjuetia me mjete dhe mënyra që shkaktojnë vrasjen ose kapjen në masë të kafshëve dhe shpendëve të egra, si gracka, kosha, rrjeta, stampa imituese, aparate zendjellëse, veç rasteve të parashikuara me ligj.

10- E shtëna në largësi nën 150 m në drejtim të qendrave urbane dhe të objekteve që paraqesin rrezik, për gjuetinë e njëthundrakëve (derr i egër etj.); largësia nga këto objekte llogaritet mbi bazën e qitjes maksimale të armëve.

11- Mbajtja e armëve të gjuetisë të karikuara gjatë kalimit në qendrat urbane (në këmbë ose në makinë) dhe transporti i tyre të mbushura, mbajtja dhe përdorimi i armëve të gjahut nga persona të tjerë të paautorizuar.

12- Kapja e shpendëve në kohën kur u bien pendët, kur kanë ngrirë nga të ftohtit, si dhe kapja e kafshëve gjatë përmbytjeve.

13- Prishja e çerdheve, dëmtimi, mbledhja, mbajtja dhe marrja e vezëve dhe e porsalindurve, vrasja ose nxjerrja nga strofka dhe shfarrosja e atyre që ndodhen në to, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.

14- Kapja ose mbajtja e gjahut nga cilido person pa lejen e organeve pyjore në kohën e riprodhimit dhe të rritjes së të vegjëlve.

15- Vrasja ose kapja mbi sasi të lejuara me qen të tjerë, veç atyre të gjuetisë, ose gjuetia me zagarë, duke kërkuar territorin pa armë gjahu.

16- Dëmtimi dhe përvetësimi i rrethimeve, ndërtimeve për gjuetinë, i vendeve të gjuetisë, i tabelave të çfarëdo lloji e natyre qofshin, i kullave të vrojtimit dhe i kafazëve të ndryshme të vendosura për zogjtë.

17- Hyrja dhe qëndrimi i njerëzve, automjeteve, kafshëve, vendosja e kampingeve, çadrave ose objekteve të tjera të kësaj natyre në rezervatet e gjuetisë, faunistike dhe në zonat e riprodhimit e të kapjes, veç vendeve e kohës së përcaktuar nga organet pyjore.

18- Kullotja e bagëtive në rezervatet faunistike dhe të gjuetisë.

19- Djegia e hamulloreve, kullotave etj. në brendësi të rezervateve dhe në afërsi deri 500 m.

20- Kapja, grumbullimi dhe tregtimi pa leje të organeve pyjore i kërminjve, reptilëve, breshkave e të bretkosave mbi sasi të caktuara dhe jashtë sezonit të grumbullimit.

Neni 36

(Ndryshuar me ligjin nr. 9219, datë 8.4.2004)

Organet e shërbimit pyjor, Policia e Shtetit, policia bashkiake dhe komunale, Inspektorati i Mjedisit dhe organet tatimore e doganore kanë të drejtë të pezullojnë e të bllokojnë veprimtarinë e subjekteve juridike dhe fizike, që kryejnë veprimtari gjuetie, përpunojnë e tregtojnë lloje ose prodhime të faunës së egër (lëkurë, pendë, mish, vezë, trofe ose dhe specie të gjalla apo të vrara), nëse ata nuk janë të pajisur me lejen përkatëse nga Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe e Kullotave dhe kur veprimtaritë e biznesit janë të licencuara nga organet përgjegjëse, si dhe bëjnë sekuestrimin e mjeteve, të armëve të gjahut, të specieve të vrara dhe të trofeve.

Neni 37

Për çdo rast të shkeljes së dispozitave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore, punonjësit e organeve të shërbimit pyjor, ata të ruajtjes së rendit dhe të pushtetit lokal mbajnë procesverbal, i cili nënshkruhet nga hartuesi, i proceduari dhe dëshmitari i pranishëm dhe, kur nuk ka të tillë, është i vlefshëm vetëm me firmën e proceduesit.

Për armët mbahet procesverbal i veçantë dhe i dërgohet organit kompetent. Gjahu i vrarë ose i kapur konfiskohet, ndërsa armët e mjetet e gjahut sekuestrohen nga organet e

shërbimit pyjor.

KREU VI KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 38

(Shtuar shkronja "l" me ligjin nr. 9219, datë 8.4.2004)

Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen si kundërvajtje administrative me gjobë si vijon:

a) Ushtrimi i gjuetisë pa u pajisur me lejen vjetore të gjuetisë dhe autorizimin e vrasjes së gjahut, dënohet me gjobë nga 25 000 deri në 50 000 lekë dhe me heqjen e së drejtës për t'u pajisur me leje gjuetie deri në 3 vjet. Në rast përsëritjeje leja e gjuetisë hiqet përgjithmonë.

b) Ushtrimi i gjuetisë jashtë zonave të programuara, ose në një zonë tjetër nga ajo e lejuar, dënohet me gjobë nga 15 000 deri në 30 000 lekë. Në rast përsëritjeje leja vjetore e gjuetisë hiqet deri në 5 vjet.

c) Kur gjuetari i pajisur me leje vjetore të gjuetisë nuk u paraqet lejen për mbajtjen e armës së gjahut dhe autorizimin e vrasjes së gjahut organeve kontrolluese, dënohet me gjobë nga 5 000 deri në 10 000 lekë.

ç) Vrasja a kapja me më shumë gjah nga sa është lejuar dhe kur ajo nuk deklarohet në organet kompetente, dënohet me gjobë nga 8 000 deri në 15 000 lekë.

d) Kur shtetasit vendas a të huaj tregtojnë lëkurë të kafshëve të egra ose edhe kafshë a shpendë të egra të çfarëdo natyre qofshin, të cilat përfshihen në listën e gjuetisë, pa lejen e organeve pyjore, dënohen me gjobë nga 50 000 deri në 80 000 lekë, si dhe konfiskimin e tyre.

Kur shtetasi vendas është gjuetar, i hiqet edhe leja e gjuetisë përgjithmonë.

dh) Vrasja, kapja, tregtimi ose mbajtja e llojeve të zogjve (kanarina, gardelina e të tjera të kësaj natyre) në një numër mbi 3, dënohen me gjobë deri në 3 000 lekë.

e) Grumbullimi i kërmillit, reptilit dhe bretkockave natyrore pa leje të organeve pyjore, jashtë sezonit të caktuar dhe mbi sasi të lejuara, dënohet me gjobë nga 5 000 deri në 8 000 lekë.

ë) Ushtrimi i gjuetisë pa derdhur taksat dhe tarifat përkatëse dënohet me gjobë deri në 15 000 lekë.

f) Importimi ose eksportimi i kafshëve e shpendëve të egra, të vrara sipas dispozitave ligjore pa dokumentacionin përkatës, dënohet me gjobë deri në 16 000 lekë.

g) Stërvitja e zagarëve të gjuetisë jashtë kohës dhe vendeve të lejuara dënohet me gjobë deri në 5 000 lekë.

gj) Kapja e shpendëve të egra në kohën e rënies së pendëve, në kohën me ngrica e në raste përmytjesh natyrore dënohet me gjobë nga 8 000 deri në 15 000 lekë.

h) Prishja e çerdheve, dëmtimi ose mbledhja e vezëve dhe e të prosalindurve dënohen me gjobë nga 2 000 deri në 4 000 lekë.

i) Hyrja ose qëndrimi i njerëzve, kafshëve, automjeteve, vendosja e kampingeve, çadrave e mjeteve të tjera të kësaj natyre, ngritja e ndërtesave pa lejet përkatëse, në rezervatet e gjuetisë e faunistike dënohen me gjobë deri në 50 000 lekë dhe me largimin ose prishjen e menjëhershme të tyre dhe detyrohet të kthejë në gjendjen e mëparshme territorin me shpenzimet e kundërvajtësit.

j) Kullotja e bagëtive në rezervatet faunistike dhe të gjuetisë dënohet me gjobë deri në 8 000 lekë.

k) Personat a gjuetarët që gjenden në zonat e gjuetisë me zagar pa matrikullën përkatëse ose pa leje të organeve pyjore, dënohen me gjobë deri në 1 000 lekë; në rastet kur gjenden me zagar, por jashtë sezonit të gjuetisë, dënohen me gjobë deri në 10 000 lekë, në rezervatet e

gjuetisë e faunistike dënohet deri në 30 000 lekë.

l) për vrasjen, kapjen tregtimin ose mbajtjen e llojeve të faunës së egër, të përcaktuara si të rralla ose në rrezik zhdukjeje, të kërcënuara ose të mbrojtura rreptësisht, vendoset gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë dhe në rast përsëritjeje vlera e saj pesëfishohet.

Neni 39

(Ndryshuar me ligjin nr. 9219, datë 8.4.2004)

Vendimi për kundërvajtjet administrative merret në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të procesverbalit.

Kundërvajtësi ka të drejtën e ankimit, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit, te Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Pyjeve dhe i Kullotave dhe më pas ka të drejtën t'i drejtohet gjykatës, sipas procedurave të parashikuara në ligjin "Për kundërvajtjet administrative".

Neni 40

(Ndryshuar me ligjin nr. 9219, datë 8.4.2004)

Shkelja e dispozitave të këtij ligji, kur pasojat materiale janë të rënda dhe përbëjnë rrezik ekologjik për mjedisin rrethues dhe jetën e kafshëve e të shpendëve të egra, përbën vepër penale dhe dënohet sipas dispozitave të Kodit Penal.

Mjetet dhe gjithçka tjetër, që shërbejnë për kryerjen e kundërvajtjeve administrative ose të veprës penale dhe çdo përfitim pasuror, i arritur nëpërmjet kundërvajtjes administrative, sekuestrohen dhe kalojnë për llogari të organeve të shërbimit pyjor.

Neni 41

Ministria e Arsimit, Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Akademia e Shkencave të marrin masa për përfshirjen në programet e shkollës njohuritë bazë për ruajtjen e mbrojtjen e mjedisit natyror dhe të faunës në veçanti.

Radio Televizioni Shqiptar dhe organet e tjera të medias, në kuadrin e një plani kombëtar të sensibilizojnë opinionin publik për mbrojtjen e mjedisit e të faunës duke organizuar emisione të veçanta për këtë qëllim.

Shoqatat joqeveritare përfshi edhe ato të gjuetarëve të japin kontributin e tyre për edukimin e anëtarëve të tyre për mbrojtjen e mjedisit e të faunës së egër të vendit tonë.

Neni 42

(Ndryshuar me ligjin nr. 9219, datë 8.4.2004)

Ngarkohen Këshilli i Ministrave, në zbatim të neneve 10 dhe 28 dhe ministritë përkatëse, në zbatim të neneve 5, 9/1, 10, 14, 16, 23 26 dhe 29/1, të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 43

Dekreti nr. 5607, datë 30.6.1977 "Për ekonominë e gjuetisë", si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 44

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 983, datë 13.12.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Sali Berisha**